



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 1 prot.

Kamëz, më 17/1.2022

V E N D I M

Nr. 1 Datë 17/1 2022

MBI

**“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA
ADMINISTRATORËT SHOQËRORË PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-
NDIHMËS EKONOMIKE”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.1.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.01 Datë 14.1.2022 Mbështetur në Ligjin 57, datë 18.07.2019 “Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM nr. 956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore”; Kreun IV, pika 2, të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve , të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar; Udhëzimit nr. 5, date 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri ne 6%”, të ndryshuar; Kreun IV, pika 3, të VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. dhe në VKB nr. 158 datë 18.12.2020 “Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së muajit DHJETOR 2021, të 44 familjeve, të cilët janë rekomanduar nga administratoret shoqërore, për përfitim nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike, me një fond prej 143,340 (njëqind e dyzetë e tremijë e treqind e dyzet) lekë.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi